

VENDIM

Nr. 6/2025

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 38, pika 3, fjalia e dytë, pas togfjalëshit “ose çështjen që diskutohet” shtohet togfjalëshi “si dhe vlerësimin parandalues të korrupsionit.”

Neni 2

Në nenin 71 pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në rast se gjatë shqyrtimit të projektligjit, amendamentet e miratuara nga komisioni ndryshojnë përmbajtjen e projektligjit mbi masën 30% të tij, komisioni duhet të kryejë edhe rivlerësimin parandalues të korrupsionit.”.

Neni 3

Në nenin 102 bëhen shtesat e mëposhtme:

Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Komisioni, në kuadër të procesit të Kontrollit Post-Legjislativ, mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara.”.

Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Komisionet e përhershme, brenda fushave përkatëse të përgjegjësisë, si pjesë të funksionit të kontrollit parlamentar ndaj ministrave dhe institucioneve të tjera publike, realizojnë procesin periodik të Kontrollit Post-Legjislativ të ligjeve të miratuara nga Kuvendi, për sa u takon zbatimit dhe efektivitetit të tyre.”.

Neni 4

Në nenin 105, pika 2/1, shkronja “d” ndryshon si më poshtë:

“d) raportet e komisioneve parlamentare, të cilat shqyrtojnë projektligjin, kanë pjesë përbërëse të tyre analizën e vlerësimit parandalues të korrupsionit.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Elisa Spiropali**

Miraturar në datën 30.1.2025.